

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 112 date 19.2.1996

PËR

KRIJIMIN E SHOQËRIË ANONIME SHTETËRORE "QENDRA E REGJISTRIMIT
TË AKSIONEVE"

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Krijohet shoqëria anonime shtetërore me emërtimin "Qendra e Regjistrimit të Aksioneve", ose shkurt "QRA", me seli në Tiranë dhe me objekt veprimtarie:

- mbajtjen me efektivitet dhe në mënyrë të rregullt të regjistrimit të aksioneve;

- sigurimin ndaj ndryshimeve jo të drejta të regjistrimit nga emetuesi ose ndonjë palë e tretë;

- transferimin e saktë dhe në kohë të pronësisë së aksioneve dhe përpunimin e të dhënave të tjera të nevojshme të llogarisë së aksionarëve;

- të sigurojë që numri i aksioneve të zotëruara nga aksionarë nuk kapërcen numrin e aksioneve të emetuara nga shoqëria;

- ruajtjen e konfidencialitetit të aksionarëve, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;

- çdo lloj tjetër funksioni teknik dhe operues në emër të aksionarëve, duke përfshirë shpërndarjen e dividendit, nxjerrjen dhe formulimin e autorizimeve, dërgesa të veçanta me postë, raportin e rregullt dhe veprime të tjera të përbashkëta të aksionarëve.

2. Madhësia dhe përbërja e kapitalit themeltar të shoqërisë caktohen nga ministri i Financave.

3. Zyrat e Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve do të caktohen në godinën e Drejtorisë së Informatikës Ekonomike- Tiranë (pesë zyra, duke përfshirë edhe korridorin, në katin e pestë), duke u transferuar me urdhër të ministrit të Financave. Fondet e nevojshme për funksionimin e kësaj qendre për një periudhë njëvjeçare do të mbulohen nga burimet e Ministrisë së Financave, në kuadrin e projektit "Krijimi dhe funksionimi i Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve" dhe të projektit "Programi i privatizimit masiv" të Ministrisë së Financave me PNUD-in.

4. Autorizohet Ministria e Financave të kryejë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e qendrës si shoqëri anonime në regjistrin tregtar dhe të përgatitë aktet e themelimit të kësaj shoqërie.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

ALEKSANDËR MEKSI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

URDHER

Nr. 126 Date 14/03/1996

Ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 112 date 19.02.1996 "Për krijimin e shoqërisë anonime shtetërore - Qendra e Regjistrimit të Aksioneve " :

Urdheroj:

I. Krijimin e shoqërisë anonime shtetërore: Sh. A. " Qendra e Regjistrimit të Aksioneve "

II. Anetar te keshillit mbikqyres caktohen:

1. zj. Lindita XHILLARI
2. z. Genc ÇIFLIKU
3. z. Artan TORO

III. Ekspertet per vleresimin e kapitalit themeltar te tyre caktohen:

1. Adriana BERBERI
2. Anesti SKENDERI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 14253 Akt.

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 21. III . 1996, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, F. Japu si shqyrtova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga Ministria e Financave per regjistrimin e shoqerise tregtare: "Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve" Tirane ne formen e nje shoqerie anonime :

KONSTATOVA SE :

Kerkuesi Ministria e Financave ka paraqitur kerkesen per t'u rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime "Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve" Tirane me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 2.614.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke me objekt veprimtarie: Mbajtjen e rregjistrimit te aksioneve te shoqerive anonime dhe transferimin e sakte e ne kohe te pronesise te aksioneve.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, Urdher Nr.126, date 14.3.1996 i Ministrise se Financave, kerkese per miratim eksperti jane te plote dhe te bazuar ne ligj dhe si te tille duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", si dhe nenit 33 ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te".

V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve" Tirane me kohezgjatje pa afat te caktuar me kapital themeltar 2.614.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke dhe me objekt veprimtarie: Mbajtja e rregjistrimit te

aksioneve te shoqerive anonime dhe transferimin e sakte e ne kohe te pronesise te aksioneve. Selia e shoqerise eshte ne Tirane.

Keshilli Mbikqyres perbehet nga :

1. Lindita Xhillari
2. Genc Çifliku
3. Artan Toro

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

Tirane, me 21. 11. 1996

GJYQTARE

(Florinus Tepu)
F. Tepu

URDHER REGJISTRIMI

14253

Me

1.

2.a. *Qendresa e Regjistrimit te Aeronave S.A*

b. *Tirane*

c. *mbajtje dhe regjistrim*

i (prop. s'pocurimi et)

3. *2.614.000 lekë (me natyre)*

3. *Aktiviteti i: Administrimi i Aeronave
E emri i kompanise
Aeron 100.*

4. Statuti nenshkruar me date *14 III 1996*

5. Data *21. III 1996*

Statuti *ka 10 Flete*

Njoftime: a. shoqeria

b. dhomen e tregtise

c. organit perkates financiar

d. zyres se statistikes

-Publikime: *x*

GJYQTARE

*F. J. J. J.
18.10.*

AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 14/03/1996, Ministria e Financave, ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 112 date 19.02.1996 "Për krijimin e shoqërisë anonime shtetërore - Qendra e Regjistrimit të Aksioneve " vendosi:

- I. Te krijoje shoqerine anonime "Qendra e Regjistrimit të Aksioneve ".
- II. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete mbajtja e regjistrit të aksioneve të shoqërive anonime dhe transferimin e saktë dhe në kohë të pronësisë te aksioneve.
- III. Shoqeria do te kete seline e saj ne qytetin e Tiranës.
- IV. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2,614,000 leke, i ndare ne 2,614 aksione, me vlere nominale 1.000 leke.
- V. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
- VI. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga.
 1. zj. Lindita XHILLARI
 2. z. Genc ÇIFLIKU
 3. z. Artan TORO
- VII. Ndertimi organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
- VIII. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

MINISTRI

DYLBER VRIONI

STATUTI
I
SHOQERISE ANONIME SHTETERORE
“QENDRA E REGJISTRIMIT TE AKSIONEVE”

Në bazë të VKM Nr. 112 datë 19.02.1996 " Për krijimin e shoqërisë anonime shtetërore - Qendra e Regjistrimit të Aksioneve ", Ministri i Financave, z. Dylber VRIONI, nënshkruan statutin e shoqërisë anonime si më poshtë:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Forma e shoqërisë

Shoqëria do të jetë shoqëri anonime pa ofertë publike në të cilën të gjitha aksionet zotërohen nga shteti (shoqëri shtetërore), për sa kohë Ministri i Financave, si përfaqësues i shtetit, nuk do të marrë një vendim për privatizimin e saj.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare ", nga ky statut, si dhe nga legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj :

- mbajtjen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt të regjistrit të aksioneve të shoqërive anonime;
- transferimin e saktë dhe në kohë të pronësisë dhe përpunimin e të dhënave të tjera të nevojshme të llogarisë së aksionerëve;
- të sigurojë që numri i aksioneve të zotëruara nga aksionerët të mos kapërcejë numrin e aksioneve të emetuara nga shoqëritë anonime;
- ruajtjen e konfidencialitetit të aksionerëve, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;
- çdo lloj operacioni teknik në emër të aksionerëve, duke përfshirë shpërndarjen e dividendit, nxjerrjen dhe formulimin e autorizimeve, dërgesa të veçanta me postë etj.
- çdo lloj tjetër operacioni tregtar, financiar, etj brenda caceve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e kësaj shoqërie.



Brënda kuadrit të dispozitave ligjore, shoqëria ka të drejtë të marrë të gjitha masat dhe të kryejë çdo biznes të përshtatshëm për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarjeve të tjera dhe pjesmarrjen në sipërmarje të tjera, si brenda ashtu dhe jashtë vendit pa cënuar objektin e shoqërisë.

Neni 3

Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i plotë i shoqërisë është "Qendra e Regjistrimit të Aksioneve".

Emërtimi i shkurtuar i shoqërisë është "QRA".

Në të gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet menjëherë nga fjalët "Shoqëri Anonime" ose inicialet "Sh.A.", duke treguar dhe shumen e kapitalit themeltar.

Neni 4

Selia (vendndodhja) e shoqërisë

Selia (vendndodhja) e shoqërisë është në Rr. "Punëtorët e Rilindjes" Tirane.

Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër me një vendim të thjeshtë të Këshillit Mbikqyrës me kusht që ky vendim të miratohet nga Ministri i Financave. Në këtë rast, Këshilli Mbikqyrës autorizohet të bëjë ndryshimet përkatëse në statutin e shoqërisë.

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, megjithatë ajo mund të ndryshohet në bazë të vendimit të Ministrit të Financave.

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Neni 6

Kapitali themeltar dhe aksionet e shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2,614,000 lekë. Ai është i ndarë në 2,614 aksione të së njëjtës kategori, të cilat zotërohen tërësisht nga shteti.

Vlera nominale e aksionit është 1,000 lekë.



Neni 7

Ndryshimi i kapitalit themeltar të shoqërisë dhe shitja e aksioneve

- I. Ndryshimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet sipas mënyrave dhe modaliteteve të përcaktuara në ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare ", ku i vetmi kopetent për të vendosur për këtë ndryshim është Ministri i Financave i cili ngarkon për të reflektuar këtë ndryshim në statutin e shoqërisë Këshillin Mbikqyrës.
- II. Aksionet e shoqërisë mund tu shiten personave fizikë dhe juridikë shqiptarë, vetëm në rastin e një vendimi të marrë nga Ministri i Financave për privatizimin e shoqërisë.

ORGANET DREJTUESE

Neni 8

Organet drejtuese të shoqërisë


Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Këshilli Mbikqyrës
2. Drejtori i Përgjithshëm

Neni 9

Këshilli Mbikqyrës

- I. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 anëtarë. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës ~~emërohen~~ emërohen nga Ministri i Financave.
- II. Kohëzgjatja e funksionit të tyre është 3 vjet. anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë të gjithë të rizgjedhshëm. Ata mund të revokohen para mbarimit të mandatit të tyre nga titullari i organit që i ka emëruar vetëm për shkaqe të përligjura.
- III. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.
- IV. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se tre muaj.
Anëtari i Këshillit Mbikqyrës i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.
- V. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se tre këshilla mbikqyrës të shoqërive anonime që e kanë selinë në territorin e



Republikës së Shqipërisë me kusht që regjistri i aksioneve të këtyre shoqërive të mos mbahet nga QRA.

Në rast se ndonjëra nga shoqëritë, në këshillin mbikqyrës të së cilës bën pjesë anëtari i Këshillit Mbikqyrës të QRA, vendos të mbajë regjistrin e saj të aksioneve në QRA, ky anëtar duhet të japë menjëherë dorëheqjen nga Këshilli Mbikqyrës i QRA ose nga shoqëria në fjalë.

- VI. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të moshës mbi 65 vjeç nuk mund të jenë më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm në mbyllje të ushtrimit të çdo viti financiar. Nëse kjo përqindje tejkalohet, anëtari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- VII. Ky këshill do të funksionojë deri në momentin e privatizimit të shoqërisë, pastaj shoqëria do të funksionojë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Kryetari dhe zv/kryetari i Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar të cilët ngarkohen të mbledhin këshillin dhe të drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikqyrës dhe janë të rizgjedhshëm.

Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij.

Neni 11

Vendimet e Këshillit Mbikqyrës

- I. Këshilli Mbikqyrës mbledhet sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, ose në mungesë të tij, të zv/kryetarit. Kryetari duhet të thërrasë Këshillin Mbikqyrës brenda pesëmbëdhjetë ditëve, kur drejtori ose një e treta e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëhere autorët e saj mund të thërrasin Këshillin Mbikqyrës duke i përmendur rendin e ditës. Në parim thirrja duhet të bëhet tre ditë përpara me letër, telegram, teleks ose faks, por ajo mund të bëhet edhe me gojë dhe pa afat, nqs anëtarët e Këshillit Mbikqyrës e pranojnë atë. Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës bëhet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.
- II. Këshilli Mbikqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, nqs janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese.
- III. Këshilli Mbikqyrës mban një regjistër të pjesmarrjes në mbledhjen e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.



- IV. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës evidentohen me procesverbale të hartuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga kryetari dhe nga një anëtar i këshillit, ose, në mungesë të kryetarit, nga jo më pak se dy anëtarë të këshillit. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari i Këshillit Mbikqyrës, zv/kryetari dhe nga drejtori i përgjithshëm.

Neni 12

Kompetencat e Këshilli Mbikqyrës

- I. Këshilli Mbikqyrës emëron drejtorin e përgjithshëm.
- II. Këshilli Mbikqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga drejtori i përgjithshëm i saj dhe i jep këtij të fundit autorizimin paraprak për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga drejtori i përgjithshëm pa autorizimin paraprak të Këshillit Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës autorizon marrëveshjet e parashikuara në nenin 16 të këtij statuti. Ai autorizon drejtorin e përgjithshëm të kryejë veprimet dhe të marrë masat e parashikuara në nenin 15 të këtij statuti.
- III. Këshillit Mbikqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe kërkon të njihet me dokumentat që ai i gjykon të nevojshme për përmbushjen e detyrës së tij. Drejtori i paraqet raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajsh nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, drejtori duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore, me qëllim verifikimin dhe kontrollin e tyre nga ky i fundit. Këshilli Mbikqyrës shqyrton llogaritë vjetore dhe raportin vjetor të paraqitur nga drejtori i përgjithshëm dhe i paraqet vërejtjet e tij Ministrisë të Financave.
- IV. Këshilli Mbikqyrës mund t'i ngarkojë njërit ose disa anëtarëve të tij çdo mandat për një ose disa objekte të caktuara.

Neni 13

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të bëhet në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 03.07.1995 " Për këshillat mbikqyrës të shoqërive shtetërore ".

Masa e shpërblimit përcaktohet nga aksionmbajtësi i vetëm.



Neni 14

Drejtori i Përgjithshëm

- I. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga Këshilli Mbikqyrës, kur për të janë dakord që të tre anëtarët e këtij këshilli. Ai mund të zgjidhet qoftë ndërmjet personave të shoqërisë, qoftë edhe jashtë të punësuarve të saj me kusht që të jetë ekspert për fushën e veprimtarisë së shoqërisë.
- II. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikqyrës emërohet drejtor, mandati i tij në këshill përfundon sapo ai të kalojë në funksionin e ri.
- III. Një person nuk mund të emërohet drejtor në më shumë se një shoqëri.
- IV. Drejtori mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikqyrës vetëm për shkaqe të përligjura. Në rastin kur i interesuari ka lidhur një kontratë punësimi me shoqërinë, shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk është shkak për zgjidhjen e kësaj kontrate.
- V. Drejtori emërohet për një periudhë kohe prej 4 vjetësh. Në rastet e pushimeve dhe të mungesave të tjera të zgjatura, Këshilli Mbikqyrës bën menjëherë zëvendësimin e tij.
- VI. Drejtori është i riemërueshëm. Ai nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç. Drejtori që mbush 65 vjeç, quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zëvendësohet menjëherë.
- VII. Mënyra dhe masa e shpërblimit të drejtorit caktohen nga Këshilli Mbikqyrës në aktin e emërimit të tij.

Neni 15

Kompetencat e Drejtorit

- I. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- II. Drejtori ka kompetenca të plota ndaj të tretëve për të vepruar në emër të shoqërisë në çfarëdo rrethane, me përjashtim të kompetencave që i janë caktuar shprehimisht Këshillit Mbikqyrës dhe Ministrit të Financave nga ligji dhe nga ky statut.
Në marrëdhënie me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorit e kapërcente objektin e shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se vetë shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
Kufizimet e kompetencave të drejtorit të përcaktuara në statut duhet të respektohen nga të tretët. Megjithatë, në cilësinë e masave të rregullit të



brendshëm të shoqërisë, por që nuk u kundërvihet të tretëve, veprimet dhe operacionet e mëposhtëm kryhen vetëm me autorizimin e Këshillit Mbikqyrës:

- përcaktimi dhe ndryshimi i programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;
 - kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe veprimet e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - hapja e veprimtarive ose njësive të reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht e pjesërisht e veprimtarive dhe njësive të shoqërisë;
 - blerja, shkëmbimi dhe shitja e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë;
 - themelimi i shoqërive ose pjesmarrja në shoqëri të tjera të krijuara, ose që do të krijohen;
 - marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorëzanive ose e garancive të tjera, kur këto të fundit e tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë;
 - negocijimi, përfundimi apo ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet, ose për një shumë detyrimesh vjetore mbi dy milionë lekë;
 - përcaktimi i kriterëve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punësimit të punonjësve;
 - dhe në përgjithësi, marrja e vendimeve dhe masave që e kapërcejnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë dhe që janë të tilla që mund të sjellin ndryshime në objektin e shoqërisë.
- III. Eshtë e detyrueshme që çdo marrëdhënie ndërmjet drejtorit të përgjithshëm dhe Këshillit Mbikqyrës të regjistrohët ose të pasqyrohet në procesverbal.
- IV. Drejtori i përgjithshëm mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gjykon të dobishme, tek një ose disa persona të tjerë që kryejnë funksione teknike në drejtimin e shoqërisë.
- V. Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të mbajnë nënshkrimin e drejtorit të përgjithshëm, ose të personit të autorizuar rregullisht nga drejtori për këto akte.
- VI. Emërimi dhe pushimi i drejtorit të përgjithshëm duhet të publikohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Marrëdhëniet brënda shoqërive përcaktohen me rregullore të veçantë e cila miratohet nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë.



Neni 16

Marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe Drejtorit ose një anëtari të Këshillit Mbikqyrës

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe drejtorit të përgjithshëm ose një anëtari të Këshillit Mbikqyrës, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo, duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të Këshillit Mbikqyrës.

Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anëtar i Këshillit Mbikqyrës është anëtar edhe i këshillit mbikqyrës të shoqërisë tjetër me të cilën propozohet të lidhet marrëveshja. Në këtë rast, Këshilli Mbikqyrës duhet të kontrollojë veçanërisht moscënimin e Nenit 9, Paragrafi 5 të këtij statuti.

Dispozitat e mësipërme nuk janë të zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimet rrjedhëse të shoqërisë që kryhen në kushte normale.

Drejtori ose anëtari i Këshillit Mbikqyrës i interesuar duhet të njoftojë Këshillin Mbikqyrës sapo merr dijeni për një marrëveshje për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statudit. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës i interesuar nuk merr pjesë në votimin e për dhënien e autorizimit.

VEPRIMTARIA FINANCIARE DHE KONTROLLI

Neni 17

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përrjashtimisht, ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar deri më 31 Dhjetor.

Neni 18

Inventari - llogaritë vjetore

- I. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimitarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore.
- II. Në mbyllje të ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.
- III. Drejtori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara për të ardhmen, ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës nga data e mbylljes të ushtrimit financiar deri në datën e hartimit të këtij raporti, si dhe veprimitaritë e shoqërisë në fushën kërkimore - shkencore.



Neni 19

Rezultati i ushtrimit dhe caktimi i fitimeve

- I. Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, duke përfshirë të këto të fundit amortizimet dhe provizionet.
- II. Nga fitimet e ushtrimit (të pakësuara, kur është rasti, me humbjet e mëparshme) hiqen të paktën 5 për qind për të krijuar rezervën e domosdoshme.
Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme, kur kjo rezervë arrin një të dhjetën e kapitalit themeltar. Ajo rifillon, kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën një të dhjetën e kapitalit themeltar.
- III. Nga fitimet e ushtrimit (të pakësuara, kur është rasti, me humbjet e mëparshme) shoqëria do të heqë jo më shumë se 85 për qind për krijimin e rezervave për zhvillim.
- IV. Shuma e fitimeve të mbetura pas heqjes për krijimin e rezervave të përmendura më sipër, përfaqëson dividendin i cili derdhet në buxhetin e shtetit.
- V. Duke përjashtuar rastin kur është vendosur zvogëlimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk bëhet asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividendi, nëq kapitali i shoqërisë është ose do të bëhej më i vogël se shuma e kapitalit themeltar plus shumën minimale të kërkuar për rezervën e domosdoshme.
- VI. Nëq ekziston një humbje, kjo mbartet për t'u përfshirë në fitimet e ushtrimit të ardhshëm deri në shuarjen e saj.
- VII. Caktimi (shpërndarja) e fitimeve dhe mënyra e mbulimit të humbjeve bëhen me vendim të Ministrit të Financave në cilësinë e tij si aksionmbajtësi i vetëm i aksioneve të shoqërisë.

Neni 20

Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrulli i veprimtarisë financiare të shoqërisë ushtrohet nga një ose dy ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga aksionmbajtësi i vetëm dhe që kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.



DISPOZITA TE TJERA

Neni 21

Emërimi i anëtarëve të parë të Këshillit Mbikqyrës

Si anëtarë të parë të Këshillit Mbikqyrës emërohen:

- | | |
|-------------------------|------------------|
| 1. zj. Lindita Xhillari | banues në Tiranë |
| 2. z. Genc Çifliku | banues në Tiranë |
| 3. z. Artan Toro | banues në Tiranë |

Neni 22

Asamblea e përgjithshme

Të gjitha atributet e asamblesë së përgjithshme të parashikuara nga ligji Nr. 7638, datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " që nuk janë shprehur në këtë statut do të ushtrohen nga Ministri i Financave, si përfaqësues i shtetit, në cilësinë e aksionmbajtësit të vetëm të aksioneve të shoqërisë.

MINISTRI I FINANCAVE

Dylber VRIONI

